



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 11.10.2022

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, me Urdhër të Kryeministrit 81, datë 10.05.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, shpall pozicionin si më poshtë:

➤ PUNONJËS MIRËMBAJTJE

➤ Detyrat kryesore të Punonjësit të Mirëmbajtjes

- Riparon dhe mirëmban dhe instalon elemente të sistemit elektrik, hidro-sistemit, inventarit dhe pajisjeve të tjera;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e hapësirë së jashtme dhe të brendshme;
- Mban evidencë rreth servisit të pajisjeve (kondicioner, pajisje hidrosanitare etj);
- Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesave të institucionit;
- I përgjigjet të gjitha kërkesave të institucionit.

➤ Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Të kenë mbaruar arsim profesional/ arsim i mesëm.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë përvojë pune të mëparshme si mirëmbajtës.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 13.10.2022, ora 16:30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollështa”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL